



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 06 Korrik 2023

Nr: 685

Ora: 12:00

V E N D I M


P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 436 ID, 438 ID, 439 ID ME KËRKUES
SINJALIZUES 385 ID, 414 ID, 410 ID, 424 ID ME KËRKUES Z. IVI KASO, 360 ID, 346 ID, 375 ID
ME KËRKUES DEPUTETIN ZJ. ALBANA VOKSHI DHE Z. IVI KASO, 394 ID ME KËRKUES
DEPUTETIN ZJ. ALBANA VOKSHI DHE KOALICIONI "BASHKË FITOJMË", 328 ID, 330 ID, 331
ID ME KËRKUES DEPUTETIN Z. FLAMUR NOKA PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE, PËR
ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 06 Korrik 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Zj. Albana Vokshi, deputet i Kuvendit të Shqipërisë
Z. Ivi Kaso, Sekretar për çështjet zgjedhore
Koalicioni "Bashkë Fitojmë"
Sinjalizues

SUBJEKT:



Këshilli Kombëtar i Territorit KKT ;
Z. Erion Isai, kryetar i bashkisë Kolonjë;
Z. Safet Gjici, kryetar i bashkisë Kukës;
Z. Gledian Llatja, kryetar i bashkisë Elbasan;
Z. Erzen Tola, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve;
Zj. Ermira Urupi, Drejtor i Zyrës Vendore Parauniversitare Elbasan;
Z. Rakip Suli, kryetar i bashkisë Kamëz;
Z. Florenc Doka, Sekretar i Përgjithshëm i bashkisë Cërrik
Subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë"

Data: 06 Korrik 2023

Nr: 685
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës, për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023"

Zj. Lindita Murati, drejtr i shkollës 9-vjeçare "Lidhja e Prizrenit"
Zj. Majlinda Bufi, kryetar i bashkisë Roskovec
Z. Pjerin Ndreu, kryetar i bashkisë Lezhë

OBJEKT: Shqyrtim administrativ për shkelje administrative në kundërshtim me parashikimet e nenit 91 të Kodit Zgjedhor

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:


Janë administruar denoncime/indicie për kryerjen e 14 (katërbëdhjetë) veprimtarive publike për institucione të ndryshme publike, për të cilat pretendohet se subjektet e denoncuar kanë shpërdoruar burimet publike në funksion të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n" e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "*Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë*", të ndryshuar përcaktojnë kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, pasi u shqyrtuan paraprakisht çështjet, u vlerësuan se informacionet apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t'u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, "*Për kundravajtjet administrative*", kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Meqenëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur disa denoncime/indicie nëpërmjet provave të ndryshme dhe meqenëse objekti i shqyrtimit bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore, në mbështetje të nenit 65, shkronja "ç" të "*Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", u vendos shqyrtimi së bashku i këtyre denoncimeve/indicieve.



Në vijim të procedurës administrative, vijoi hetimi administrativ, duke kryer hetim në lidhje me veprimtaritë e denoncuara.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka kërkuar nga institucionet publike nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve të pretenduara.

Denoncimet/indiciet e shqyrtuara nëpërmjet kësaj vendimmarrje janë si më poshtë vijon:

- Denoncim regjistruar me nr. 438 ID, [REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]



[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

- Denoncim regjistruar me 439 ID, [REDACTED]
[REDACTED]:

[REDACTED]

[REDACTED]



[REDACTED]




[REDACTED]

[REDACTED]

- Denoncim regjistruar me 436 ID, [REDACTED]



[REDACTED]



[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

- **Denoncim regjistruar me nr. 385 ID**, nëpërmjet shkresës nr. 169 prot., datë 2.5.2023, administruar pranë nesh me shkresën 4544 prot., datë 3.5.2023, nga z. Ivi Kaso ku pretendohet se *“Kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj, me miratimin e Kryeministrit, pak ditë përpara zgjedhjeve miraton 7 (shtatë) leje të reja ndërtimi për kulla në Tiranë.*

Në lidhje me denoncimin e marrë, në datë 4.5.2023, Bashkisë Tiranë i është kërkuar informacion, nëpërmjet adresës elektronike, dhe më datë 5.5.2023, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Tiranë, ndër të tjera bën me dije se :

Në lidhje me denoncimin 385 ID : *“Bashkia e Tiranës në përputhje me parashikimet e legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit është institucion vendor, ndërsa Këshilli Kombëtar i Territorit është organ kolegjal që funksionon pranë Këshillit të Ministrave dhe kryesohet nga Kryeministri. Mbledhja objekt denoncimi është një mbledhje e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT).”*

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 8.5.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por nuk pati të përfaqësuar nga Bashkia Tiranë.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ për denoncimin **nr. 385 ID**, vlerësoj se :

Referuar nenit 9, pika 1 të Kodit Zgjedhor parashikohet se, *“me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të*



partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia".

Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator ka dalë në zbatim të nenit 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe çdo dispozitë e tij duhet të lexohet në kuadër të kërkesave dhe qëllimeve që kanë këto nene. Qëllimi i dispozitës është që të garantojë paanshmëri dhe trajtim të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për **mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime zgjedhore**.

Aktivitet e ndaluara dhe periudha e ndalimit përshkruhen dhe sanksionohen në nenin 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Në zbatim të kësaj dispozite nuk vlerësohet se dhënia e lejeve të ndërtimit përfshihet në këtë kategori veprimtarie. Sa më sipër, në mungesë të një dispozite ndaluese, nxjerrja e kësaj kategorie lejesh nuk mund të jenë objekt shqyrtimi për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Palët në këtë proces nuk mund të procedohen për miratimin e lejeve, që në momentin kur janë nxjerrë, nuk janë parashikuar nga Kodi Zgjedhor si shkelje administrative. Në këtë kuadër, miratimi i këtyre akteve prej të denoncuarit mbetet brenda parashikimeve të ligjit. Për sa më sipër në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë procesit administrativ, rezulton se objekti për këto denoncime nuk përmban elementë për konstatimin e shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

- **Denoncim regjistruar me nr. 414 ID**, marrë me shkresën nr. 186 prot., datë 9.5.2023, administruar pranë nesh me shkresën 4865 prot., datë 9.5.2023, nga z. Ivi Kaso ku pretendohet se: *"Në datën 26.04.2023 Kryetari i Bashkisë Kolonjë z. Erion Isai, i ka propozuar Këshillit Bashkiak miratimin e Projekt-Vendimeve nr. 54, 55, 63 për dhënie të sipërfaqeve për përdorim në fshatin Rehovë, fshatin Qinam, fshatin Tac-Agalli, fshatin Selenicë dhe Qendër Novoselë, me qëllim ndërtimin e një parku fotovoltaike dhe zhvillimin e një impianti për prodhimin e energjisë së rinovueshme nga dielli dhe era"*.

Më datë 11.5.2023, i është kërkuar informacion bashkisë Kolonjë në lidhje me indicien e marrë, por personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, nuk i është përgjigjur kërkesës sonë.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, vlerësoj se:

Referuar nenit 91, pika 4, të Kodit Zgjedhor ku përcaktohet se *"Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënie të përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensione, mbështetjes ekonomike apo*

sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore”.

Në qoftë se bëjmë leximin “fjalë për fjalë” të nenit 91, pika 4, të Kodit Zgjedhor, “deri në formimin e qeverisë së re” duket se legjislatori e kufizon “miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore, që parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara” vetëm për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvend. Sa më sipër, në mungesë të një dispozite ndaluese, nxjerrja e kësaj kategorie aktesh për zgjedhjet vendore, nuk mund të jenë objekt shqyrtimi për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Palët në këtë proces nuk mund të procedohen për miratimin e akteve, që në momentin kur janë nxjerrë, nuk janë parashikuar nga Kodi Zgjedhor si shkelje administrative. Në këtë kuadër, miratimi i këtyre akteve prej të denoncuarit mbetet brenda parashikimeve të ligjit.

Për sa më sipër në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë procesit administrativ, rezulton se objekti për këto denoncime nuk përmban elementë për konstatimin e shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

- **Denoncimet regjistruar me nr. 360 ID dhe 346 ID**, ku pretendohet se Kryetari/kandidati i bashkisë Kukës, z. Safet Gjici në faqen e tij “Facebook” ka shpërndarë postime të cilat bien në kundërshtim me dispozitat ligjore. Për të njëjtin subjekt dhe objekt, kanë ardhur 2 (dy) denoncime të regjistruara me nr. 360 ID, me kërkues z. Ivi Kaso dhe me nr. 346 ID, me kërkues zj. Albana Vokshi, deputet i Kuvendit të Shqipërisë.

Denoncimi **nr. 360 ID**, më kërkues z. Ivi Kaso, sekretar i çështjeve ligjore, nëpërmjet shkresës nr. 141 prot., datë 20.4.2023, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 4144 prot., datë 24.4.2023 ku pretendohet se “z. Safet Gjici ka promovuar në rrjetin e tij social FB punime të kryera nga Drejtoria e Rrugëve Rurale për rehabilitimin e rrugëve, takime me stafin dhe nxënësit e gjimnazit “Havzi Nela”, takime me stafin e kopshteve dhe të çerdheve, janë publikuar në media foto dhe video të shpërndarjes së pakove dhe ndihmave për familjet në nevojë, etj, duke kryer veprimtari për qëllime zgjedhore, në kundërshtim me dispozitat ligjore.”

Denoncimi **nr. 346 ID**, me kërkues zj. Albana Vokshi, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, nëpërmjet ndërfaqes së denoncimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi me nr. 11140, i datës 21.4.2023 ku pretendohet i njëjti fakt si në denoncimin **nr. 360 ID**.

Nëpërmjet e-mail të datës 26.04.2023 me lëndë “Kërkesë për informacion” i është kërkuar personit përgjegjës, informacion sqarues në lidhje me denoncimin regjistruar nr. 346 ID dhe nëpërmjet e-mail të datës 27.04.2023, jemi informuar se:

“Publikimet të cilat kanë në fokus punimet e kryera nga Drejtoria e Rrugëve Rurale për rehabilitimin e rrugëve, janë të deklaruar nga institucioni i bashkisë si aktivitete, me përjashtim

Data: 06 Korrik 2023

Nr: 685
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës, për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

të rasteve emergjente. Duke ditur që territori i bashkisë Kukës është malor dhe si e tillë, gjatë dimrit në zona të thella ka prani të borës por dhe reshje shiu, të cilat po na shoqërojnë edhe gjatë këtyre ditëve. Në këto raste emergjente drejtoria në fjalë ka ndërhyrë për të bërë të mundur hapjen e rrugëve dhe rehabilitimin e tyre për t'u ardhur në ndihmë banorëve të zonave të thella, për të mos patur probleme në qarkullimin e automjeteve për çdo problematikë jetësore që banorët kanë.

Në nëntor të vitit 2022, bashkia ka filluar punën për rikonstruksionin e gjimnazit "Havzi Nela". Nisur nga kjo nxënësit e kësaj shkolle që në muajin nëntor zhvillojnë mësimin pasdite në dy shkolla të tjera të qytetit pa cënuar procesin mësimor për dy shkollat 9-vjeçare të qytetit por edhe gjimnazit "Havzi Nela". Për shkak të rikonstruksionit por edhe të disa nismave që të rinjtë e gjimnazit kanë ndërmarrë për bashkëmoshatarët e tyre, kryetari në fund të muajit janar ka pritur në zyrë, një grup nxënësish të shoqëruar nga stafi pedagogjik i shkollës, takimi i cili ka ardhur nga kërkesa e vetë nxënësve për t'u takuar me kryetarin. Në lidhje me këtë aktivitet, institucioni i bashkisë, gjatë muajit shkurt ka paraqitur pranë KQZ edhe arsyet se pse është zhvilluar ky aktivitet.

Kryetari me stafin e kopshteve dhe çerdheve ka konsumuar kafe rastësisht, ku është ftuar në tavolinë pas orarit të punës e cila nuk ka në fokus takim punë apo elektorat, por një kafe sebepi mes kolegësh (ditelindje fëmije të njerës edukatore).

Për sa i përket shpërndarjes së pakove në natën e Fitër Bajramit, datë 20 prill 2023. Nënvizojmë se: 100 pakot ushqimore-higjenike të shpërndara atë ditë, nuk janë pako të shpërndara në emër të Bashkisë Kukës, dhe as janë bërë me fonde të Bashkisë Kukës, ato janë donacion nga shoqata "Jetimët e Ballkanit" për ti shpërndarë tek njerëzit në nevojë të bashkisë së Kukësit për festën e Fitër Bajramit. Kjo pasi bashkia ka bashkëpunim shumë të ngushtë e të hershëm me këtë shoqatë shumë serioze e cila ka ndërtuar dhjetra shtëpi për familje ekstermisht në nevojë por edhe ka dhënë, gjithmonë, donacione ushqimore në raste festash. Theksojmë se kjo shoqatë që nga koha e Covid-19 e në vijim ka dhuruar pako ushqimore për fëmijët jetimë dhe familje në nevojë pothuajse rregullisht. Lista e tyre është publike dhe shërbimi social gjithmonë ka bërë shpërndarjen e tyre. (Bashkangjitur deklaratën e dhurimit bërë nga shoqata). Po këtë ditë 20 prill 2023, natën e Fitër Bajramit, donacioni i 100 pakove ushqimore u shpërndanë në media, dhe u trajtua, me qëllim, si pako të dhënë nga bashkia nga z. Bekim Lekica, mësues në gjimnazin "Havzi Nela" dhe në shkollën 9-vjeçare "Lidhja Prizrenit" njëherazi gazetar në Fax Neës, si dhe sekretari i medias pranë Partisë Demokratike (koalicioni Bashkë Fitojmë), i përfshirë në fushatën zgjedhore të kandidatit koalicionit Bashkë Fitojmë. Z. Lekica ka intimiduar donacionin nga shoqata Jetimët e Ballkanit, duke i shpërndarë në media dhe duke e cilësuar si shpërndarje të ushqimeve për shkak të fushatës zgjedhore. Shkresa e cila përcjell donoacionin e dhënë për natën e Fitër Bajramit, nga Jetimët e Ballkanit mban NR. 01-130/23 me datë 20.04.2023. Atë ditë, 20 prill, ne kemi parë edhe shpërndarjen e pakove ushqimore nga kandidati i BF në ambjentet e jashtme të Xhamisë Kukës ku edhe atje ka besimtarë që mund të intimidohen nisur nga këndvështrimi i kandidatit të BF, por ne e konsiderojmë siç është: dhuratë nga shoqata "Jetimët e Ballkanit" "Prizren në kuadër të ndihmave të vazhdueshme që kjo shoqatë ka dhënë për familjet jetime dhe ato në nevojë. Në asnjë rast bashkia Kukës, kryetari dhe njëherësh

Data: 06 Korrik 2023

Nr: 685
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës, për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023"

kandidati nuk kanë blerë, shpërndarë, përmendur apo nënkuptuar dhuratat për fushatë. Shkresa dhe logoja e shoqatës e ngjitur në pakot ushqimore dhe higjienike janë të qarta. Ka qëlluar festa e fitër Bajramit në kohë fushate, por dhuratat nga donatorët, organizatat, kandidatët të BF apo të tjerë të bëra në këtë natë të fitër Bajramit janë traditë shqiptare dhe nuk lidhen me fushatën.”

Në përfundim të hetimit administrativ, vlerësoj se:

Pas shqyrtimit të fakteve dhe provave të administruara për denoncimet me nr. **360 ID dhe 346 ID**, vlerësoj se referuar nenit 91, pika 1 të Kodit Zgjedhor ku parashikohet se *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administruar të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.*

Pasi vlerësova secilin denoncimi veçmas, rezultoi se aktivitetet e denoncuar, janë aktivitete publike të cilat janë raportuar në ndërfaqe, pra është përmbushur detyrimi ligjor i përcaktuar në dispozitat e nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Veprimtaritë e raportuara janë konsideruar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve si veprimtari të lejuar për t’u zhvilluar.

Denoncuesi pretendon se nëpërmjet publikimit në faqen personale të kryetarit të bashkisë Kukës janë përdorur burime publike pasi janë promovuar investime me fonde publike.

Referuar nenit 3, pika 1.1 shkronja “a” dhe “b”, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator “ku parashikohet se *“1. 1 “veprimtari të ndaluara për tu promovuar” janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë:*

- a) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, me interes apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjetikës, të telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, në shërbim dhe interes të publikut;*
- b) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik, si edhe ato në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës, rinisë, sporteve dhe të arsimit publik në të gjitha nivelet, si dhe të infrastrukturës, në shërbim të interesit publik”.*

Që të kemi shkeljen e kësaj dispozite, duhet të vërtetohet se fondet e projekteve që promovohen, duhet të jenë vënë “rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe njëkohësisht të ketë promovim për këto investime.

Megjithatë të ndodhur në kushtet që postimet janë bërë në llogaritë personale të kryetarit të bashkisë, u vlerësua se postimi në rrjetet sociale personale nuk mund të përbëjnë prova të mjaftueshme për të provuar lidhjen midis postimit dhe përdorimit të fondeve publike. Subjektet zgjedhore kanë karakter dhe natyrë politike dhe si i tillë mund të postojë në faqen personale mesazhe politike, promovim të nismave politike, festim të arritjeve politike apo çdo lloj materiali tjetër politik, për tërheqjen e elektoratit. Theksohet se legjislacioni në fuqi, referuar këtu ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nuk parashikojnë asnjë rregullim ligjor të shprehur mbi administrimin e mediave sociale nga ana e subjekteve zgjedhore. Në kushtet kur nuk është e qartë apo e rregulluar shprehimisht nga ligji kufiri i përdorimit të këtyre mjeteve të komunikimit, pretendimet e palës denoncuese janë të pabazuara dhe jo të përligjura. Postimet në llogaritë personale në rrjetin social "facebook" të subjektit zgjedhor, dalin jashtë fushës së zbatimit dhe objekti të rregullimit të Kodit Zgjedhor dhe akteve normative në fuqi dhe si të tilla nuk mund të trajtohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Për sa më sipër, vlerësoj se duhet të pushohet procedimi administrativ për denoncimet e regjistruara me **nr. 360 ID dhe 346 ID**, pasi nuk u arrit të provohej shkelja e nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe as të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

- **Denoncim regjistruar me nr. 375 ID**, ndaj bashkisë Elbasan për 7 (shtatë) veprimtari, për të cilat pretendohet si vijon: Denoncimi **375 ID**, më kërkues **z. Ivi Kaso**, sekretar i çështjeve ligjore, nëpërmjet shkresës nr. 151 prot., datë 27.4.2023, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 4554 prot., datë 3.5.2023 **dhe zj. Albana Vokshi**, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, nëpërmjet ndërfaqes së denoncimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi me nr. 12596, i datës 28.4.2023 ku pretendohet se: *"Kryetari i bashkisë Elbasan dhe kandidat i Partisë Socialiste për këtë bashki z. Gledian Llatja publikon në rrjetin e tij social Facebook takime dhe promovime siç janë:*

1. *Bashkë me zj. Elva Margariti, z. Damian Gjikhuri, e deputetë të zonës promovojnë nismën e qeverisë për Bonusin e Rijetësimin për pronarë e përdorues të objekteve të ndryshme;*
2. *I pranishëm bashkë me ministren zj. Elvis Kushi dhe z. Damian Gjikhuri gjatë zhvillimit të një aktiviteti në pallatin e sportit "Tomorr Sinani" Elbasan;*
3. *Promovon projekte infrastrukturore në shkollën "Luigj Gurakuqi", "Konstandin Kristoforidhi" dhe shkollën artistike "Onufri" Elbasan;*
4. *Bashkë me ministren zj. Bora Muzhaqi dhe nxënës në Qendrën Rajonale të Formimit Profesional dhe Qendren Rinore Elbasan, prezantojnë kurset e kodimit me mbështetje nga qeveria;*
5. *Bashkë me Kryeministrin dhe z. Gjikhuri, z. Llatja promovon Auto Moto Park Albania;*
6. *Promovon rritjen e pagave të punonjësve;*
7. *Bashkë me z. Gjikhuri promovojnë investime në fabrikën "M&M Topuzi Konstrukione Metalike" Elbasan;*



Në kuadër të hetimit administrativ, më datë 4.5.2023, i është kërkuar informacion personave përgjegjës për raportimin të subjekteve të denoncuara, në lidhje me indicien e marrë nëpërmjet shkresës nr. 4554, datë 3.5.2023. Më datë 5.5.2023, personi përgjegjës për raportim i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ka bërë me dije se: *“Lidhur me aktivitetin e zhvilluar në Pallatin e Sportit “Tomor Sinani”, në datën 8 Prill 2023, me pjesëmarrjen e Ministres së Arsimit dhe Sportit zj. Evis Kushi, ju sqarojmë se ky aktivitet u organizua nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, (KOKSH) në kuadrin e programit “Ekipet Sportive” me nxënës të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të Qarkut Elbasan dhe Ministri zj. Evis Kushi ka qenë e ftuar. Aktiviteti ka qenë i hapur për publikun dhe mund të merrte pjesë kushdo që dëshironte. Ministria e Arsimit dhe Sportit ka pasqyruar në KQZ, çdo aktivitet të zhvilluar nga ky institucion gjatë periudhës parazgjedhore në respektim të plotë të Kodit Zgjedhor dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi”.*

Në vijim të hetimit u zhvillua seanca dëgjimore e datës 8.5.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke dhënë të drejtën për tu shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, në seancë ishte e pranishme përfaqësuesja e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, e cila parashitroi pretendimet duke sqaruar se: *Ministria e Arsimit dhe Sportit ka qenë në cilësinë e të ftuarit në këtë aktivitet.*

Në seancë ishte e pranishme përfaqësuesja e ZVA Elbasan, e cila sqaroi se: *Aktiviteti i vetëm i organizuar nga shkollat nën juridiksionin e Zyrës Vendore Arsimore Elbasan është panairi “Dita e Verës 2023”, aktivitet i zhvilluar në datë 9.3.2023, nga shkollat në kuadër të nismës Shkollat Qendër Komunitare. Shkollat Qendër Komunitare është një model promovues dhe zhvillues për ta kthyer shkollën në vendin ku ndërtohet partneriteti shkollë-familje-komunitet dhe bashkëpunohet për zhvillimin potencial të çdo nxënësi. Ky aktivitet është një aktivitet social-kulturor dhe jo aktivitet politik, i organizuar nga shkollat pjesëmarrëse të cilat nuk kanë person përgjegjës për raportim në KQZ dhe Zyra Vendore Arsimore ka qenë e ftuar në këtë aktivitet.*

Në përfundim të hetimit administrativ, vlerësoj se pikat 1, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të denoncimit regjistruar me nr. 375 ID, referuar nenit 91, pika 1 të Kodit Zgjedhor parashikohet se *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”.*

Pas verifikimit të secilit denoncim veçmas, rezultoi se aktivitetet e denoncuara, të cilat rezultuan të ishin aktivitete publike janë raportuar në ndërfaqe dhe rezultuan të kenë përmbushur detyrimet e nenit 92, të Kodit Zgjedhor. Veprimtaritë e raportuara janë konsideruar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve si veprimtari të lejuar për t'u zhvilluar.

Denoncuesi pretendon se nëpërmjet publikimit në faqen personale të kryetarit të bashkisë Elbasan dhe janë përdorur burime publike pasi janë promovuar investime me fonde publike.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi verifikoi secilin pikë veçmas, referuar nenit 3, pika 1.1 shkronja "a" dhe "b", të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator "ku parashikohet se "1. 1 "veprimtari të ndaluara për tu promovuar" janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë:

a) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, me interes apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjetikës, të telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, në shërbim dhe interes të publikut;

b) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik, si edhe ato në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës, rinisë, sporteve dhe të arsimit publik në të gjitha nivelet, si dhe të infrastrukturës, në shërbim të interesit publik".

Që të kemi shkeljen e kësaj dispozite, duhet të vërtetohet se fondet e projekteve që promovohen, duhet të jenë vënë "rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe njëkohësisht të ketë promovim për këto investime.

Megjithatë të ndodhur në kushtet që postimet janë bërë në llogaritë personale të kryetarëve të bashkisë, u vlerësua se postimi në rrjetet sociale personale nuk mund të përbëjnë prova të mjaftueshme për të provuar lidhjen midis postimit dhe përdorimit të fondeve publike. Subjektet zgjedhore kanë karakter dhe natyrë politike dhe si i tillë mund të postojë në faqen personale mesazhe politike, promovim të nismave politike, festim të arritjeve politike apo çdo lloj material tjetër politik, për tërheqjen e elektoratit. Theksohet se legjislacioni në fuqi, referuar këtu ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nuk parashikojnë asnjë rregullim ligjor të shprehur mbi administrimin e mediave sociale nga ana e subjekteve zgjedhore. Në kushtet kur nuk është e qartë apo e rregulluar shprehimisht nga ligji kufiri i përdorimit të këtyre mjeteve të komunikimit, pretendimet e palës denoncuese janë të pabazuara dhe jo të përligjura. Postimet në llogaritë personale në rrjetin social "facebook" të subjektit zgjedhor, dalin jashtë fushës së zbatimit dhe objekti të rregullimit të Kodit Zgjedhor dhe akteve normative në fuqi dhe si të tilla nuk mund të trajtohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Referuar pikës 2 të denoncimit regjistruar me nr. 375 ID, vlerësohet se pas verifikimit të rrethanave dhe faktet e paraqitura, vlerësojmë se ZVA Elbasan dhe Ministria e Arsimit dhe

Data: 06 Korrik 2023

Nr: 685
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës, për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023"


Sportit në këtë aktivitet, kanë qenë në cilësinë e të ftuarit. Ky aktivitet është një aktivitet social-kulturor dhe jo aktivitet i organizuar nga shkollat pjesëmarrëse të cilat nuk kanë person përgjegjës për raportim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Për sa më sipër, vlerësoj se duhet të pushohet procedimi administrativ për denoncimin regjistruar me nr. **375 ID** pasi nuk u arrit të provohej shkelja e nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe as të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

- **Denoncim regjistruar me nr. 410 ID**, me kërkues z. Ivi Kaso, sekretar i çështjeve ligjore, nëpërmjet shkresës nr. 180 prot., datë 28.5.2023, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 4866 prot., datë 9.5.2023 ku pretendohet se *"Disa javë para zgjedhjeve vendore 14 majit, kandidati i PS për Bashkinë Kamëz njofton rrjetin e tij FB si më poshtë:*

1. *Promovim i punimeve të kryera në rrugën "Harku i Triumfit", bashkë me Kryetaren e Kuvendit Lindita Nikolla*
2. *Promovimi i projektit për rikualifikimin e zonës për rindertimin në Valias;*
3. *Promovimi i punimeve për ndricimin e rrugeve "Azem Hajdari", "Bubullime", "Librazhd", "Neë York" dhe "Besim Cera";*
4. *Promovim i përfundimit të punimeve në urën që lidh Laknasin me Valiasin;*
5. *Promovimi i punimeve në ndërtimin e KUN-se në Frutikulturë;*
6. *Promovimi i punimeve për rikualifikim urban të zonës në Valias;*
7. *Promovimi i përfundimit të punimeve në rrugën Luzi i Vogel.*
8. *Promovimi i përfundimit të punimeve për qendrën shëndetësore Zall-Manër.*
9. *Promovimi i punimeve në rrugët Nato, "Pashko Vasa", "Josef Marksën", "Isa Boletini" dhe "Haki Taho".*

Më 11.5.2023 i është kërkuar informacion bashkisë Kamëz përsa pretendohet nga denoncuesit dhe me datë 12.5.2023 jemi informuar se *"Nga ana e Bashkisë Kamëz është realizuar detyrimi ligjor për raportimin e veprimtarive në fjalë me karakter publik. Në ndërfaqen e raportimeve janë të pasqyruara të gjitha aktivitetet që janë raportuar konform të gjitha parashikimeve dhe kritereve ligjore, përfshirë këtu afatet, tematikën e veprimtarisë, personat pjesëmarrës, folësit kryesorë, vendi i zhvillimit etj. Pretendimet e denoncuesve janë të pabazuara jo vetëm për faktin se aktivitetet janë raportuar, por edhe sepse pretendimet e tyre ndryshojnë objektin dhe përmbajtjen e postimeve për të cilat bëhet fjalë. Lidhur me lëvrimin e fondeve për punimet që janë objekt denoncimi, ju informojmë se, fondet janë lëvruar tashmë prej muajsh, në zbatim të procedurave ligjore.*

Bashkia Kamëz e ushtron veprimtarinë e saj në mbështetje e zbatim të legjislacionit rregullues, përfshirë këtu çdo akt ligjor e nënligjor në fuqi. Ju vëmë në dijeni se: Insitucioni ynë ka ndërmarrë të gjitha masat me qëllim zbatimin e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të



ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” si edhe cdo akti tjetër juridik me qëllim përgatitjen dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023”.

Në përfundim të hetimit administrativ, vlerësoj se:

Pas shqyrtimit të fakteve dhe provave të administruara për denoncimin regjistruar me nr. **410 ID**, referuar nenit 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor parashikohet se *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.*

Pas verifikimit të secilit denoncim veçmas, rezultoi se aktivitetet e denoncuara, të cilat rezultuan të ishin aktivitete publike janë raportuar në ndërfaqe dhe rezultuan të kenë përmbushur detyrimet e nenit 92, të Kodit Zgjedhor. Veprimtaritë e raportuara janë konsideruar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve si veprimtari të lejuar për t’u zhvilluar.

Denoncuesi pretendon se nëpërmjet publikimit në **faqen personale të kryetarit të bashkisë Kamëz** janë përdorur burime publike pasi janë promovuar investime me fonde publike.

Referuar nenit 3, pika 1.1 shkronja “a” dhe “b”, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “ku parashikohet se “1. 1 “veprimtari të ndaluara për tu promovuar” janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, **për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë:**

- a) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, me interes apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjetikës, të telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, në shërbim dhe interes të publikut;*
- b) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik, si edhe ato në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës, rinisë, sporteve dhe të arsimit publik në të gjitha nivelet, si dhe të infrastrukturës, në shërbim të interesit publik”.*

Që të kemi shkeljen e kësaj dispozite, duhet të vërtetohet se fondet e projekteve që promovohen, duhet të jenë vënë “rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe njëkohësisht të ketë promovim për këto investime.

Megjithatë të ndodhur në kushtet që postimet janë bërë në llogaritë personale të kryetarit të bashkisë, u vlerësua se postimi në rrejtet sociale personale nuk mund të përbëjnë prova të mjaftueshme për të provuar lidhjen midis postimit dhe përdorimit të fondeve publike. Subjekti zgjedhore kanë karakter dhe natyrë politike dhe si i tillë mund të postojë në faqen personale mesazhe politike, promovim të nismave politike, festim të arritjeve politike apo çdo lloj materiali tjetër politik, për tërheqjen e elektoratit. Theksohet se legjislacioni në fuqi, referuar këtu ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nuk parashikojnë asnjë rregullim ligjor të shprehur mbi administrimin e mediave sociale nga ana e subjekteve zgjedhore. Në kushtet kur nuk është e qartë apo e rregulluar shprehimisht nga ligji kufiri i përdorimit të këtyre mjeteve të komunikimit, pretendimet e palës denoncuese janë të pabazuara dhe jo të përligjura. Postimet në llogaritë personale në rrjetin social "facebook" të subjektit zgjedhor, dalin jashtë fushës së zbatimit dhe objekti të rregullimit të Kodit Zgjedhor dhe akteve normative në fuqi dhe si të tilla nuk mund të trajtohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Për sa më sipër, vlerësoj se duhet të pushohet procedimi administrativ për denoncimin regjistruar me nr. 410 ID, pasi nuk u arrit të provohej shkelja e nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe as të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.


- **Denoncim regjistruar me nr. 328 ID**, me kërkues z. Flamur Noka, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, nëpërmjet shkresës nr. 121 prot., datë 17.4.2023, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 3915 prot., datë 18.4.2023 ku pretendohet se "*Në datë 30.3.2023, në media është publikuar foto e Kryetarit të Bashkisë Cërrik dhe z. Damian Gjikhuri në fshatin Shalës duke promovuar përdorimin e burimeve publike në prag të fushatës, veprim ky në kundërshtim me dispozitat ligjore*".

Referuar denoncimit nr. 328 ID, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 213, datë 28.3.2023, ka vendosur ndalimin e zhvillimit të veprimtarisë objekt denoncimi. Pas marrjes informacion për zhvillimin e kësaj veprimtarie, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka nisur hetimin administrativ, dhe ka arritur në përfundimin se është shkelur neni 9, i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Përsa më sipër, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, nëpërmjet vendimit nr. 56, datë 11.4.2023 "Për shqyrtimin e kërkesës nr. 12, datë 6.4.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve" ka vendosur sanksion administrativ ndaj z. Florenc Doka, Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Cërrik. Në këto kushte, vlerësoj se rasti objekt denoncimi përbën rast të gjykuar dhe për këto arsye duhet të pushohet hetimi administrativ.

- **Denoncim regjistruar me nr. 331 ID**, me kërkues z. Flamur Noka, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, nëpërmjet shkresës nr. 122 prot., datë 17.4.2023, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 3918 prot., datë 18.4.2023 ku pretendohet se: "*Në datën 07.04.2023, në media është publikuar denoncimi i kryer nga z. Ylli Manjani për formularët e shpërndarë nga administrata shtetërore për punëmarrësit të cilët duhet t'i plotësojnë ato me qëllim votimi, veprim ky në kundërshtim me dispozitat ligjore të Kodit*

Data: 06 Korrik 2023

Nr: 685
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës, për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023"

Zgjedhor, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator dhe urdhërit nr. 46, datë 22.01.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”.

Më datë 11.5.2023, subjektit zgjedhor “Partisë Socialiste të Shqipërisë” i është kërkuar informacion në lidhje me objektin e denoncimit, por nuk i janë përgjigjur kërkesës sonë.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 26 Prill 2023, ora 12:00, ku u ftuan në këtë proces palët për denoncimin me nr. 331 ID, duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi por nuk pati përfaqësues nga asnjë nga palët.

Për shkak të kompleksitetit të çështjes, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet vendimit nr. 667, datë 21 Qershor 2023 “Për zgjatjen e afatit të hetimit administrativ për denoncimet nr. 328 ID, 330 ID, 331 ID, 336 ID, 346 ID, 360 ID” ka vendosur zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit nr. 331 ID.

Në përfundim të hetimit administrativ, vlerësoj se:


Denoncuesi pretendon se administratës i është ushtruar presion për plotësimin e një formulari, në mënyrë që të siguronin vota të mjaftueshme për kandidatin për kryetar bashkie të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” në mënyrë që të ndikojnë në rezultatin e zgjedhjeve të organeve të qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023. Gjatë hetimit administrativ, pala denoncuese ka vënë në dispozicion një artikull të shkruar nga një gazetar dhe një formular i cili nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me subjektin përfitues (në rast se realisht është shpërndarë) si dhe të dhëna nga kush është shpërndarë.

Neni 91, i Kodit Zgjedhor, ndalon përdorimin e burimeve publike në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje. Po në këtë nen, përcaktohet se burimet njerëzore të institucioneve nuk mund të përdoren në mënyrë të detyruar, brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, apo tu premtohen ose ofrohen përfitime nga pjesëmarrja në aktivitete zgjedhore. Ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim do të bënte konstatimin e shkeljes së këtij neni. Denoncuesi pretendon se kanë ardhur shumë ankesa nga punonjës, megjithatë nuk ka pasur asnjë provë konkrete apo bazë të mjaftueshme të dhënash për të hetuar konkretisht mbi faktet e pretenduara dhe për presionin e ushtruar ndaj tyre. Në këto kushte për aq sa nuk u vërtetua presioni i ushtruar mbi administratën, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ për mos konstatim të shkeljes së nenit 91, të Kodit Zgjedhor.

- **Denoncim regjistruar me nr. 424 ID**, me kërkues z. Ivi Kaso, sekretar i çështjeve ligjore, nëpërmjet shkresës nr. 194 prot., datë 11.5.2023, e administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 5057 prot., datë 12.5.2023 ku pretendohet se *“Drejtoresha e shkollës 9- vjeçare “Lidhja e Prizrenit”, zj. Lindita Murati, ka mbledhur nxënësit dhe maurantët e gjimnazit “Isa Boletini”, në një festë të organizuar nga PS. Gjatë festës duket se zj. Murati, e cila kërkon votat e maurantëve në favor të kandidatit z. Rakip Suli, kandidat për kryetar në*

Data: 06 Korrik 2023

Nr: 685
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës, për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

bashkiën Kamëz Drejtoresha e shkollës në Paskuqan, Lindita Murati mbledh nxënësit në festë dhe bën fushatë për Rakip Sulin.mp4 Drejtoresha e shkollës në Paskuqan, Lindita Murati mbledh nxënësit në festë dhe bën fushatë për Rakip Sulin.”

Nëpërmjet adresës elektronike, Zyrës Vendore Arsimore Kamëz, i është kërkuar informacion në datë 13.5.2023 në lidhje me denoncimin e marrë.

Më datë 15.5.2023, Zyra Vendore Arsimore Kamëz, bën me dije se *“Zyra Vendore Arsimore Kamëz nuk ka patur dijeni në lidhje me aktivitetin e zhvilluar pasi ai është bërë jashtë orarit zyrtar. Çka është publikuar në media duke qenë se është jashtë orarit zyrtar, përgjegjësia është e vetë individit ose pjesëmarrësve në aktivitet apo takim.”*

Në përfundim të hetimit administrativ, vlerësoj se:

Referuar nenit 91, pikave 1 dhe 2 të Kodit Zgjedhor, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia. Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit.

Po ky nen parashikon se me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.

Në mënyrë që të konstatohet shkelja e kësaj dispozite duhet që të plotësohen në mënyrë komulative kriteret që përcakton nga ky nen:

- 1- përdorim i detyruar dhe i organizuar;
- 2- brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar;
- 3- në fushatë zgjedhore (referuar nenit 77, pika 1 të Kodit Zgjedhor, fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve) ose **premtimi ose ofrimi** i përfitimeve nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të mësimin si dhe **ushtrimi i presionit** ndaj tyre për këtë qëllim.

Referuar rastit konkret, zj. Lindita Murati është drejtor i shkollës 9- vjeçare "Lidhja e Prizrenit" ka qenë pjesëmarrëse në një aktivitet më maturanët e gjimnazit “Isa Boletini”, një shkollë tjetër nga ku ajo

Data: 06 Korrik 2023

Nr: 685
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës, për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

ushtron detyrën e saj. Referuar përgjigjes së ZVA Kamëz, aktiviteti me pjesëmarrjen e nxënësve të arsimit parauniversitar dhe e drejtorit të shkollës "Lidhja e Prizërenit" nuk është organizuar nga shkollat nën juridiksionin e kësaj ZVA-je. Denoncuesi pretendon se aktiviteti është organizuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", megjithatë nuk ka pasur prova të mjaftueshme për të vërtetuar faktin e pretenduar.


Nga ana tjetër, nuk u arrit të provohej nga denoncuesi dhe as nga hetimi administrativ se aktiviteti është organizuar gjatë orarit mësimor, si një kusht për të konstatuar shkeljen e pikës 2, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor. Gjatë shqyrtimit të materialit audio dhe video, të administruar si provë gjatë hetimit administrativ, nuk u arrit të provohej përfitimi apo ofrimi i përfitimeve nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të mësimit si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim. Zj. Murati, gjatë fjalës së saj ka drejtuar një ftesë të hapur për pjesëmarrjen e nxënësve në një aktivitet elektoral, por kjo nuk vërteton faktin se ka pasur ushtrim presioni për pjesëmarrje.

Nga hetimi administrativ i kryer dhe nga provat materiale të administruara në dosjen hetimore administrative, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se nuk u arrit të provohej shkelja e nenit 91, pika 1 dhe 2 e Kodit Zgjedhor nga zj. Lindita Murati, drejtor i shkollës "Lidhja e Prizërenit", dhe për këto arsye, duhet të pushohet hetimi administrativ për sa pretendohet nga denoncuesi.

- **Denoncim regjistruar me nr. 394 ID**, ndaj zj. Majlinda Bufi, kryetare e bashkisë Roskovec, për të cilën pretendohet si vijon:

Denoncimi me kërkues Zj. Albana Vokshi, i ardhur nëpërmjet portalit të denoncimeve me nr. unik 13371, datë 6.5.2023, ku pretendohet si vijon: *"Piranjat denoncojnë audio-pergjimin e kryebashkiakes dhe kandidates së PS në Roskovec, Majlinda Bufi, që i bën presion një pastruesje me vendin e punës pse kishte shkuar në një takim të Berishës. Pasi përballlet me audiopërgjimin, Majlinda Bufi e konfirmon faktin dhe i lutet gazetares së Piranjave të mos e publikojë materialin. Si deputete e Kuvendit të Shqipërisë, kërkoj marrjen e masave të menjëherëshme përfshirë saksionet të parashikojnë dispozitat ligjore për këtë qëllim, lidhur me veprimet e kryera, sipas provave të paraqitura bashkëlidhur."*

Denoncimi me kërkues Koalicioni "Bashkë Fitojmë", i ardhur shkresërisht i administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga ana jonë me nr. 4725 prot., datë 6.5.2023, ku pretendohet si vijon: *"Ditën e djeshme datë 5 maj 2023 nëpërmjet emisionit Piranjat, në televizionin Syri TV, jemi njohur me një skandal ku përfshihej personalisht kryetarja e bashkisë Rroskovec zj. Majlinda Bufi, e cila nën ndikimin e pozicionit publik të kryetares së bashkisë, me zë dhe figurë, në periudhë zgjedhore (9 ditë përpara datës së zgjedhjeve), kërcënon hapur punonjës të administratës me largim nga puna për me qëllimin e vetëm që lidhet me keqpërdorimin e administratës për avantazh elektoral."*



<https://www.youtube.com/watch?v=rarXyzY3Qz0>

Më datë 6.5.2023, bashkisë Roskovec i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e marrë, nëpërmjet adresës elektronike, ku institucioni bën me dije se: *“Së pari, videoja e transmetuar nga emisioni Piranjat është një montim i pjesëve të ndryshme në kohë dhe jo e plotë e cila del nga konteksti i bisedës së realizuar me punonjësen në zyrën e Titullarit të Institucionit.*

Së dyti, regjistrimi audio i punonjësës në zyrën e kryetarit të bashkisë ka ndodhur në periudhën Korrik-Gusht 2022 dhe nuk ka lidhje me zgjedhjet pasi në këtë periudhë nuk është dekretuar as data e zgjedhjeve as nuk ka qënë periudhë e fushatës zgjedhore.

Diskutimi konsiston në një kërkesë që kjo punonjëse, zj. Nikoleta Vesho me detyrë “Sanitare në shkollën Suk 2” ka kërkuar në zyrën e kryetarit të bashkisë për t’u transferuar në shkollën Suk 1 pasi kjo shkollë ndodhej më afër vendbanimit të saj.

Për këtë, pas diskutimeve në zyrë, nga ana e bashkisë Roskovec është vendosur transferimi sipas kërkesës së saj pranë Shkollës Suk 1, ku edhe ka vendbanimin punonjësja (aktet e ndryshimit të pozicionit po jua vendosim në dispozicion bashkëlidhur këtij e-maili) dhe ndaj kësaj punonjëse nuk është marrë asnjë masë vërejtje apo largim nga puna apo masë tjetër disiplinore.

Lidhur me videon që Piranjat kanë transmetuar kryetarja e bashkisë, njëkohësisht edhe kandidate për kryetare po vijon rrugën gjyqësore për shpifje dhe denigrim të figurës së saj duke përdorur regjistrime të cilat nuk kanë aspak lidhje me fushatën zgjedhore.

Theksojë se: Periudha e regjistrimit të diskutimit të punonjësës është në muajt Korrik-Gusht 2022, periudhë kur nuk është dekretuar akoma data e zgjedhjeve lokale 2023, si edhe diskutimi i realizuar nuk ka lidhje me zgjedhjet vendore 2023, rrjedhimisht ky regjistrim nuk mund të përbëjë keqpërdorim të administratës për fushatën zgjedhore dhe as ndonjë shkelje tjetër në fushën e zgjedhjeve.”

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 11.5.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

Lidhur me këtë seancë, pala e denoncuar ka paraqitur kërkesën për shtyrjen e seancës për shkak të pamundësisë për t’u paraqitur.

Në përfundim të hetimit administrativ, vlerësoj se:

Referuar nenit 91, pikave 1 dhe 2, të Kodit Zgjedhor, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të

organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia. Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142, të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit.

Po ky nen parashikon se me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe **ushtrimi i presionit** ndaj tyre për këtë qëllim.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ zj. Nikoleta Vesho, nëpërmjet vendimit nr. 179 prot., datë 30.8.2022 “Vendim për ndryshim vendi pune” të bashkisë Roskovec, është transferuar nga pozicioni “Sanitare” në shkollën “Ajet Toska” Suk 2, në shkollën “5 Dëshmorët” Suk 1. Në materialin audio, të administruar si provë, gjatë diskutimit me kryetarin e bashkisë zj. Bufi, zj. Nikoleta Vesho ka kërkuar transferimin në shkollën Suk 1, pasi kjo shkollë ndodhej më afër vendbanimit të saj. Nga dokumentacioni, rezultoi e provuar se zj. Vesho është transferuar në shkollën “5 Dëshmorët” Suk 1, më datë 30.8.2022.

Bashkia Roskovec, në kthimin e përgjigjes deklaroi faktin se regjistrimi, objekt denoncimi ka ndodhur në periudhën Korrik-Gusht 2022. Sqarojmë se në këtë periudhë, nuk ka qenë ende e dekretuar data e zgjedhjeve dhe rrjedhimisht nuk ka pasur ende kandidatë zyrtarë për kryetar bashkie në Roskovec. Sa më sipër vlerësoj se ushtrimi i presionit është i dënueshëm, pavarësisht periudhës kur ai është kryer, por Kodi Zgjedhor qartësisht kërkon “ushtrimin e presionit” **për qëllime zgjedhore** në mënyrë që të konstatohet shkelja. Mungesa e kandidatëve për zgjedhjen e organeve të qeverisjes vendore, nuk vërteton qëllimin zgjedhor si kërkesë për të vërtetuar shkeljen e nenit 91 të Kodit Zgjedhor. Nga hetimi administrativ i kryer dhe nga provat materiale të administruara në dosjen hetimore administrative, vlerësoj se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është në pamundësi për të vlerësuar nga pikëpamja teknike vërtetësinë e videos së vënë në dispozicion, për sa i përket përmbajtjes së saj dhe periudhës kur është regjistruar, vlerësim i cili kryhet nga organe të specializuara, dhe për këto arsye, pushohet hetimi administrativ duke kërkuar nga denoncuesi të drejtohet në organet ligjzbatuese.

- **Denoncim regjistruar me 330 ID, më kërkues z. Flamur Noka**, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, nëpërmjet shkresës nr. 123 prot., datë 17.4.2023, e administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 3917 prot., datë 18.4.2023 ku pretendohet se: *“Në datën 13.04.2023, në rrjetin social FB Bashkia Lezhë ka promovuar shpërndarjen e ndihmave ushqimore tek banorët nga personat me veshje të uniformave të Policisë, veprim ky në kundërshtim me dispozitat ligjore.”*



Më datë 26.4.2023 i është kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe bashkisë Lezhë në lidhje me indicien e marrë dhe më datë 15.5.2023 jemi informuar se *“Në përgjigje të e-mail-it Tuaj, datë 26.04.2023, nga verifikimet dhe të dhënat e dërguara nga Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, ju informojmë se **personat për të cilët pretendohen në denoncimin e mësipërm, nuk janë punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit. Strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit kanë qenë dhe janë të angazhuara maksimalisht për respektimin e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe akteve të tjera me karakter normativ të nxjerra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, lidhur me procesin zgjedhor.”***

Personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Lezhë, nuk i është përgjigjur kërkesës sonë për informacion.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 26 Prill 2023, ora 12:00, ku u ftuan në këtë proces palët për denoncimin me **nr. 330 ID**, duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi por nuk pati përfaqësues nga asnjë nga palët.

Për shkak të kompleksitetit të çështjes, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet vendimit nr. 667, datë 21 Qershor 2023 *“Për zgjatjen e afatit të hetimit administrativ për denoncimet nr. 328 ID, 330 ID, 331 ID, 336 ID, 346 ID, 360 ID”* ka vendosur zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit nr. 330 ID.

Në përfundim të hetimit administrativ vlerësoj se:

Referuar nenit 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor parashikohet se, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, **nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor**, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”.

Në zbatim të këtij neni, Komisioni Rregullator i ka nxjerrë vendimin nr. 9, datë 24.12.2020. Çdo dispozitë e tij duhet të lexohet në kuadër të kërkesave dhe qëllimeve që kanë këto nene. Qëllimi i dispozitës është që të garantojë paanshmëri dhe trajtim të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për **mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime zgjedhore**. Vendimi nuk ka për qëllim të ndalojë funksionimin normal të institucioneve shtetërore dhe as të ndalojë procedura normale administrative që kryejnë këto institucione.

Referuar nenit 3, pika 1.3, shkronja “c” e këtij vendimi parashikon se vënia **në dispozicion e asetëve të luajtshme dhe të paluajtshme** të parashikuara në nenin 142, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, *“Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar, **për qëllime zgjedhore**, që janë në pronësi apo

Data: 06 Korrik 2023

Nr: 685
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës, për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njërive të vetëqeverisjes vendore, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, **përbën shpërdorim të burimeve publike.**

Në mënyrë që të konstatohet shkelja e dispozitave të vendimit nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, përvec kërkesave që parashikon neni 3, pika 1.3, shkronja "c", duhet njëkohësisht të vërtetohet qëllimi zgjedhor në shpërndarjen e këtyre ndihmave ushqimore apo në promovimin e tyre. Fakti që këto ndihma janë shpërndarë në periudhë zgjedhore jo domosdoshmërisht vërteton qëllimin zgjedhor, si kërkesë absolutisht të domosdoshme për vërtetimin e shkeljes.

Denoncuesi ka vënë në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve një material fotografik ku tregohen një grup personash të pa identifikuar, me një kuti me ndihma ushqimore. Materiali fotografik i është dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit e cila ka konfirmuar se personat për të cilët pretendohen në denoncimin e mësipërm, nuk janë punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit. Nga ana tjetër, pavarësisht se nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është nisur një hetim administrativ, pasi denoncimi shërbeu si indicie se mund të ketë patur përdorim të burimeve publike në mbështetje të fushatës zgjedhore të kandidatit njëkohësisht dhe kryetar i bashkisë Lezhë, provat e depozituara nga denoncuesi nuk kanë qenë të mjaftueshme për të vërtetuar shkeljen e pretenduar nga ana e denoncuesit. Të ndodhur në kushtet që edhe gjatë hetimit administrativ nuk u arrit të provohej për aq sa pretendohet nga denoncuesi, vlerësojmë se duhet të pushohet hetimi administrativ për denoncimin nr. 330 ID.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, nenet 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S :

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj:

- a) [REDACTED]
- b) [REDACTED]
- c) [REDACTED]
- d) Këshilli Kombëtar i Territorit KKT ;
- e) Z. Erion Isai, kryetar i bashkisë Kolonjë;
- f) Z. Safet Gjici, kryetar i bashkisë Kukës;
- g) Z. Gledian Llatja, kryetar i bashkisë Elbasan;

Data: 06 Korrik 2023

Nr: 685
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës, për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023"

- h) Z. Erzen Tola, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve;
 - i) Zj. Ermira Urupi, Drejtor i Zyrës Vendore Parauniversitare Elbasan;
 - j) Z. Rakip Suli, kryetar i bashkisë Kamëz;
 - k) Z. Florenc Doka, Sekretar i Përgjithshëm i bashkisë Cërrik
 - l) Subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë"
 - m) Zj. Lindita Murati, drejtor i shkollës 9-vjeçare "Lidhja e Prizrenit"
 - n) Zj. Majlinda Bufi, kryetar i bashkisë Roskovec
 - o) Z. Pjerin Ndreu, kryetar i bashkisë Lezhë
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

